

# Statistikat e transportit

## Korrik 2017

**Tiranë, më 28 Gusht 2017:** Volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte, në muajin Korrik 2017 është 372 mijë ton. Krahasuar me Korrik 2016, ky tregues është rritur me 24,6 %.

Në shtatëmujorin e 2017, volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte është 2.319 mijë ton, duke u rritur me 9,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2016.

Porti i Durrësit zë 88,0 %, të të gjithë mallrave të ngarkuara/shkarkuara në të gjitha portet.

Volumi i mallrave të transportuara me hekurudhë është 1,7 mln ton - kilometër, duke u rritur me 115,3 %, krahasuar me Korrik 2016.

Në shtatëmujorin 2017, ky volum është 14 mln ton- kilometër, duke u rritur me 166,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2016.

**Tab. 1 Transporti i mallrave me det, me hekurudhë dhe me ajër**

ton

Periudha	Me det	Me hekurudhë	Me ajër*
Korrik - 2016	298.492	5.650	171
Korrik - 2017	372.013	8.650	188
Ndryshimi vjetor (%)	24,6	53,1	9,9
Janar - Korrik 2016	2.119.796	42.760	1.246
<sup>P</sup> Janar - Korrik 2017	2.319.489	90.157	1.289
<sup>e</sup> <sub>r</sub> Ndryshimi vjetor progresiv (%)	9,4	110,8	3,5

*Përfshin mallrat dhe postën*

Në muajin Korrik 2017, volumi i mallrave të transportuar me ajër është 188 ton, duke u rritur 9,9 %, krahasuar me Korrik 2016.

Në shtatëmujorin e 2017, me ajër janë transportuar 1.289 ton mallra, duke u rritur 3,5 %, krahasuar me shtatëmujorin e 2016.

**Për publikim 28/08/2017**

Numri i fluturimeve të kryera, në Korrik 2017, është 2.496, duke shënuar një rritje me 19,0 %, ndaj Korrik 2016.

Në shtatëmujorin e 2017, janë kryer 13.236 fluturime, duke u rritur me 10,8 %, krahasuar me njëjtën periudhë të një viti më parë.

**Tab. 2 Treguesit e transportit ajror**

Periudha	Numri i shoqërive ajrore	Numri i fluturimeve	Numri mbikalimeve
Korrik - 2016	14	2.096	22.172
Korrik - 2017	18	2.494	21.645
Ndryshimi vjetor (%)	28,6	19,0	-2,4
Janar - Korrik 2016	14	11.948	91.591
Janar - Korrik 2017	18	13.236	90.343
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	28,6	10,8	-1,4

Në muajin Korrik, numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linja ajrore është 293.064, duke u rritur 31,2 %, krahasuar me Korrik 2016.

Në shtatëmujorin e 2017, transporti ajror i pasagjerëve zë 65,7 % të transportit gjithsej. Numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linja ajrore, në shtatëmujorin 2017 është 1.413.390, duke u rritur me 24,1 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

**Tab.3 Transporti i pasagjerëve sipas mënyrës së udhëtimit**

Periudha	Transporti i pasagjerëve		
	Me hekurudhë	Me det	Me ajër
Korrik - 2016	11.760	188.966	223.442
Korrik - 2017	15.611	232.530	293.064
Ndryshimi vjetor (%)	32,7	23,1	31,2
Janar - Korrik 2016	66.720	583.714	1.138.984
Janar - Korrik 2017	40.050	699.064	1.413.390
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	-40,0	19,8	24,1

Numri i pasagjerëve që udhëtojnë me linjë detare në Korrik 2017 është 232.530 persona, krahasuar me Korrik 2016, ky tregues është rritur 23,1 %.

Në shtatëmujorin e 2017, kanë udhëtuar me linjë detare 699.064 pasagjerë, duke u rritur me 19,8%, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

### Eksporti/Importi i mallrave sipas mënyrës së transportit


Në Korrik 2017, vlera e mallrave të tregtuara (eksport dhe import) është 79 mld lekë dhe 53,8 % e tyre u transportuan me det.

#### Eksportet e mallrave

Në Korrik 2017, mallrat e eksportuara me det zënë 63,0 %, me rrugë 35,4 % dhe me ajër 0,4 %.

Mallrat e eksportuara me rrugë, në Korrik 2017, janë rritur me 28,7 % dhe me det janë rritur 1,7 %, krahasuar me Korrik 2016.

Fig. 1 Struktura e eksporteve sipas mënyrës së transportit, Korrik 2017



Gjatë shtatëmuorit 2017, mallrat e eksportuara me det zënë 63,7 %, me rrugë 34,9 % dhe me ajër 0,4%.


Mallrat e eksportuara me rrugë, në shtatëmuorin 2017, u rritën 25,9 % dhe me det u rritën 9,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

#### Importet e mallrave

Në Korrik 2017, mallrat e importuara me det zënë 49,6 %, me rrugë 45,6 % dhe me ajër 2,8 %.

Mallrat e importuara me hekurudhë, në Korrik 2017, janë ulur me 15,5 % dhe me det janë rritur me 3,4 %, krahasuar me Korrik 2016.

Fig.2 Struktura e importeve sipas mënyrës së transportit, Korrik 2017




Gjatë shtatëmujorit 2017, mallrat e importuara me det zënë 50,3 %, me rrugë 44,1 % dhe me ajër 2,9 %.

Mallrat e importuara me hekurudhë, në shtatëmujorin 2017, janë rritur 53,4 % dhe me rrugë janë ulur me - 4,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

**Mallrat kryesore të eksportuara sipas mënyrës së transportit**

Pesë grup-mallra, sipas Nomenklaturës së Transportit (NST 2007), kanë kontribuar me 79,1%, në vlerën e mallrave të eksportuara në muajin Korrik 2017.


Fig. 3 Pesë grup-mallra kryesore të eksportuara sipas mënyrës së transportit



**Mallrat kryesore të importuara sipas mënyrës së transportit**

Pesë grup-mallra, sipas Nomenklaturës së Transportit (NST 2007), kanë kontribuar me 70,8 % të vlerës së mallrave importuar gjithsej në muajin Korrik 2017.

**Fig. 4 Pesë grup-mallra kryesore të importuara sipas mënyrës së transportit**



# Metodologji

## **Përkufizime:**

**Transport:** Lëvizja e njerëzve dhe/ose mallrave, duke përdorur mjete të ndryshme transporti. Transporti mund të kryhet me mjete të transportit tokësor, ajror dhe detar.

**Transporti hekurudhor:** Çdo lëvizje e mallrave dhe/pasagjerëve duke përdorur mjete me rrota të drejtuar mbi binarë.

**Transport detar:** Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur anije tregtare në udhëtime, të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me det.

**Transport ajror:** Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur avionë në udhëtime, të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me ajër.

**Eksportet** janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

**Vlera F.O.B:** Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

**Importet** janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

**Vlera C.I.F:** Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit, edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

**Nomenklatura e Statistikave të Transportit (NST 2007)** është një nomenklaturë mallrash e përdorur kryesisht për statistikën e transportit

**Burimi i të dhënave:** Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

*Të dhënat e transportit detar, ajror dhe hekurudhor janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/cilesia-statistikore.aspx/> Politika e revizionimit statistikor.*

## **Shpjegimi i simboleve**

0 vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

- pa vlerë